

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Praktika e Auditimit të
Brendshëm
Internal Audit Practice**

B3

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 16/10/2022

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

1. Faktori kryesor për suksesin e programit të burimeve njerëzore të një organizate për departamentin e auditimit është:
 - A. Një grup i kriterëve të zhvilluara mirë për përzgjedhjen e stafit.**
 - B. Një program për njohjen e interesave të veçanta të anëtarëve të stafit individual.
 - C. Një program jo-formal për zhvillimin dhe këshillimin e stafit.
 - D. Një plan kompensimi i bazuar në përvojën e punës.
2. Aftësitë e anëtarëve të personelit janë karakteristika kryesore në efektivitetin e një departamenti të auditimit të brendshëm. Zgjidhni konsideratën kryesore të përdorur kur punësoni një person në departamentin e auditimit të brendshëm.
 - A. Edukimin e vazhdueshëm.
 - B. Përshkrimet e punës.**
 - C. Orientimin organizativ
 - D. Kontrollat e reputacionit.
3. Cila nga aktivitetet e mëposhtme NUK përbën mbikëqyrje të auditimit?
 - A. Sigurimi i udhëzimeve të përshtatshme për auditorët.
 - B. Rishikimi i dokumenteve të punës së auditimit.
 - C. Përgatitja e programit paraprak të auditimit.**
 - D. Të siguruarit që objektivat e auditimit janë arritur.
4. Cila nga aktivitetet e mëposhtme NUK përfshihet në përcaktimin e orarit të auditimit?
 - A. Vlerësimi i faktorëve të rrezikut.
 - B. Planifikimi i kërkesave të punës.
 - C. Identifikimi i lokacioneve të cilat do të auditohen.
 - D. Zhvillimi i programeve të auditimit.**
5. Arsyetimi më i mirë për rotacionin e auditorëve të brendshëm në mënyrë që individë të ndryshëm të caktohen në auditime të njëpasnjëshme të një auditimi të caktuar është që të:
 - A. Rritet kujdesi i ushtruar nga auditorët e brendshëm të cilët e dinë që cilësia e punës së tyre do të jetë e dukshme për grupin tjetër të auditorëve të brendshëm.
 - B. Promovohen zhvillime të shpejta profesionale nga ana e auditorëve të brendshëm duke i ekspozuar ata në gamën e plotë të aktiviteteve organizative.
 - C. Parandalohet dështimi nga ana e auditorit të brendshëm, i cili mund të çojë në qarkullim të tepërt në departamentin e auditimit të brendshëm.
 - D. Shmangen zhvillimet e paragjykitimit ndaj një auditimi të caktuar.**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

6. Sipas Standardeve IIA, raportet e aktivitetit të një departamenti të auditimit të brendshëm duhet të:
 - A. **Krahasojnë auditimet e përfunduara me auditimet e planifikuara.**
 - B. Listojnë gjetjet materiale të auditimeve kryesore.
 - C. Listojnë gjetjet e pazgjidhura.
 - D. Raportojnë aktivitetet javore të auditorëve individualë.

7. Cili nga faktorët e mëposhtëm shërben si një kontribut i drejtpërdrejtë i buxhetit financiar të departamentit të auditimit të brendshëm?
 - A. Raportet e aktivitetit
 - B. **Oraret e punës së auditimit**
 - C. Statuti i departamentit të auditimit
 - D. Efektiviteti në të kaluarën i departamentit të auditimit të brendshëm në identifikimin e kostove të kursimeve.

8. Komunikimi i suksesshëm konsultativ në një auditim të brendshëm bazohet pjesërisht në reagimet e të audituarëve për veprimet e auditorëve gjatë auditimit. Ky reagim (feedback):
 - A. Duhet të shkojë vetëm tek menaxhmenti i lartë si një mjet për të rishikuar auditorët.
 - B. Duhet të shkojë vetëm tek auditorët për t'i ndihmuar ata të përmirësojnë performancën e tyre të auditimit.
 - C. **Duhet të shkojë te menaxhmenti dhe auditorët për t' u siguruar që vlera e biznesit po shtohet.**
 - D. Do të mbrojë të audituarit nga auditorët.

9. Një auditor i brendshëm që dyshon në mashtrim duhet:
 - A. Të përcaktoj që është shkaktuar një humbje.
 - B. Të intervistoj ata që janë përfshirë në kontrollin e pasurive.
 - C. Të identifikoj punonjësit që mund të jenë të përfshirë në këtë çështje.
 - D. **Të rekomandoj çfarëdo hetimi që konsiderohet i nevojshëm për rrethanat.**

10. Një auditor i brendshëm nuk arrin të zbulojë një mashtrim të punonjësve gjatë një auditimi. Mos-zbulimi ka shumë të ngjarë të sugjerojë një shkelje të Standardeve IIA nëse ishte rezultat i:
 - A. Moskryerjes së një auditimi të detajuar të të gjitha transaksioneve të zonës.
 - B. Përcaktimi që kostoja e zgjerimit të procedurave të auditimit në zonë do të tejkalonte përfitimet e mundshme.
 - C. Përcaktimi se çdo mashtrim i mundshëm në zonë nuk do të përfshinte një shumë materiale.
 - D. **Supozimi se kontrollet e brendshme në zonë ishin adekuate dhe efektive.**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

11. Gjatë një auditimi, një auditor zbulon se një nëpunës po përvetësonte fondet e kompanisë. Edhe pse ky është përvetësimi i parë i hasur ndonjëherë dhe kompania ka një departament sigurie, auditori vendos të marrë në pyetje personalisht të dyshuarin. Nëse auditori po shkel Kodin e Etikës, rregulli i shkelur ka shumë të ngjarë të jetë:
- A. Mungesa e kompetencës në këtë fushë.**
 - B. Dështimi për të treguar kujdes të duhur.
 - C. Mungesa e besnikërisë ndaj organizatës.
 - D. Mosrespektimi i ligjit.
12. Kërkesa që blerjet të bëhen nga furnitorët në një listë të miratuar të furnitorëve është shembull i një:
- A. Kontrolli zbulues
 - B. Kontrolli korigjues
 - C. Kontrolli të monitorimit
 - D. Kontrolli parandalues**
13. Auditimi i performancës është përshkruar si "*vlerësimi i performancës së menaxhmentit kundrejt një sërë objektivash dhe qëllimesh të pranuar*". Auditimet e performancës në përgjithësi përqendrohen në efikasitet dhe efektivitet, me theks të veçantë në efektivitet. Shembulli më i mirë i një auditimi të performancës do të ishte vlerësimi i:
- A. Kostos së implementimit të një ndryshimi të madh që synon ta bëjë sistemin e kontabilitetit të kostos më të përgjegjshëm ndaj nevojave të përdoruesit.
 - B. Suksesi i objektivit të një agjencie qeveritare për të përmirësuar sigurinë e ashensorit.**
 - C. Nivelit të stafit të një komiteti të ngritur për të monitoruar planifikimin e prodhimit.
 - D. Sa i përshatën punëtorët procedurave të vendosura të operimit në një linjë montimi.
14. Cila nga situatat e mëposhtme do të bënte që një auditor i brendshëm të vinte në dyshim përshtatshmërinë e kontrolleve të brendshme në një funksion blerjeje?
- A. Dokumentet origjinale dhe një kopje e porosisë së blerjes i dërgohen furnitorit me postë. Kopja në të cilën furnitori pranon pranimin e porosisë së blerjes i kthehet departamentit të blerjes.
 - B. Raportet e pranimit dërgohen në departamentin e blerjeve, aty ato përputhen me porositë e blerjes dhe dërgohen tek departamenti i llogarive të pagueshme.**
 - C. Departamenti i llogarive të pagueshme përgatit dokumentacionin për pagesa.
 - D. Dosjet e faturave të papaguar dhe regjistrat e përhershëm të inventarit mirëmbahen në mënyrë të pavarur.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

15. Inventari i një ndërmarrje prodhuese përfshin një investim të rëndësishëm në metalet e çmuara. Rishikimi i sistemit të menaxhimit të kontrolleve të brendshme nga auditorët mbi këta artikuj ka shumë të ngjarë të përfshijë:
- I. Rishikimin e procedurave për të siguruar që vlera e materialeve është e shënuar siç duhet në pasqyrën e pozitës financiare.
 - II. Rishikimin e formave të blerjes së materialeve për miratime, dhe gjurmimi i formave të lëshimit në regjistrat e përhershëm të inventarit për të verifikuar që inventari është lëshuar me autorizimin e duhur.
 - III. Vëzhgimin e transaksioneve të inventarit për të konstatuar nëse po ndodhin vjedhje materiale.
 - IV. Rishikimin e sistemit të departamentit të prodhimit për krahasimin e përdorimit të këtyre metaleve me standardet.
- A. III dhe IV
B. I dhe IV
C. Vetëm I
D. II dhe III
16. Njëri nga dy nëpunësit e një kompanie të vogël përgatit një faturë shitje për 4,300 EUR; megjithatë, fatura është futur gabimisht nga kontabilisti në regjistrin e librit kryesor dhe librin e llogarive të arkëtueshme të regjistruar si 3,400 EUR. Konsumatori më pas zvogëlon menjëherë, shumën në deklaratën mujore në 3,400 EUR. Duke supozuar se ka vetëm tre punonjës në departament, kontrolli më efektiv për të parandaluar këtë lloj gabimi është:
- A. Caktimi i nëpunësit të dytë të zyrës për të kontrolluar në mënyrë të pavarur çmimet e faturave të shitjes, uljet, shtesat, bazat dhe llogarinë për numrin serik të faturës.
 - B. Kërkesa që deklaratat mujore të përgatiten nga kontabilisti dhe të verifikohen nga nëpunësit e tjerë të zyrës përpara se të dërgohen tek klientët .
 - C. Përdorimi i totaleve të paracaktuara për të kontrolluar rutinat e regjistrimeve.**
 - D. Kërkimi nga kontabilisti që të kryer rakordime periodike të librit të llogarive të arkëtueshme dhe librit kryesor.
17. Për të përcaktuar nëse kontrollet e letër kredive zbatohen në mënyrë jo konsistente, duke parandaluar shitjet e vlefshme për klientë të vlefshëm, auditori duhet:
- A. Konfirmoj llogaritë e arkëtueshme.
 - B. Gjurmoj regjistrimet në librin e llogarive të arkëtueshme.
 - C. Analizoj normat e mbledhjes dhe historitë e kredive.
 - D. Krahasoj historitë e kredive për ata që marrin kredi dhe për ata që nuk kanë kredi.**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

18. Një asistent i auditimit gjeti një urdhër blerje nga një furnitor i rregullt në shumën prej 5,500€. Data e urdhrit të blerjes ishte pas datës së pranimit të mallit. Agjenti i blerjeve shpjegoi se ai kishte harruar të lëshonte urdhrin e blerjes. Gjithashtu, një pagesë prej 450€ për materiale nuk kishte një raport pranues. Asistenti dëshironte të zgjidhte porosi shtesë të blerjeve për hetim, por nuk ishte i shqetësuar për mungesën e një raporti pranues. Drejtori i auditimit duhet të:
- A. Pajtohet me asistentin pasi shuma e përjashtimit të porosisë së blerjes ishte dukshëm më e madhe se sa përjashtimi i raportit pranues.
 - B. Pajtohet me asistentin pasi që agjenti i blerjeve e kishte bindur nëpunësin e disbursimit të parave të gatshme që mos plotësimi i një raporti nuk ndodh shumë shpesh.
 - C. Nuk pajtohet me asistentin pasi të gjitha problemet që lidhen drejtpërdrejt me koston kanë një rrezik të barabartë humbjeje të lidhur me to.
 - D. Nuk pajtohet me asistentin pasi mungesa e një raporti pranues ka një rrezik më të madh humbjeje të lidhur me të.**
19. Një mënyrë për të parandaluar vonesat e prodhimit si pasojë e prishjes dhe riparimeve të pajisjeve është që të:
- A. Programoni prodhimin bazuar në shfrytëzimin e kapacitetit.
 - B. Buxhetoni aktivitetet e departamentit të mirëmbajtjes bazuar në një analizë të urdhrave të punës së pajisjeve.
 - C. Vendosni një program mirëmbajtje parandalues për të gjitha pajisjet e prodhimit.**
 - D. Autorizoni urdhërat e punës së departamentit të mirëmbajtjes dhe pagën e orëve shtesë.
20. Cila nga opsionet e mëposhtmet NUK paraqet përfitim të përdorimit të teknologjisë së informacionit në zgjidhjen e problemeve të auditimit?
- A. Rrit mundësitë e auditimit.
 - B. Përmirëson gjykimin e auditorit.**
 - C. Ndihmon në uljen e rrezikut të auditimit.
 - D. Përmirëson afatet kohore të auditimit.
21. Shumica e organizatave janë të shqetësuara për kompromisin e mundshëm të fjalëkalimeve. Cila nga procedurat e mëposhtme do të ishte më efektive në kontrollimin ndaj përdorimit të paautorizuar të fjalëkalimit të dikujt tjetër?
- A. Lejoni vetëm përdoruesit të ndryshojnë fjalëkalimet e tyre dhe inkurajojini ata të ndryshojnë fjalëkalimet shpesh.
 - B. Zbatoni një program kompjuterik që teston për të parë që fjalëkalimi nuk është i lehtë për tu qëlluar.
 - C. Zbatoni përdorimin e teknikave të vërtetimit, me anë të të cilave përdoruesi përdor një çelës për të gjeneruar një fjalëkalim dhe verifikon si çelësin ashtu edhe fjalëkalimin e gjeneruar në sistem.**
 - D. Kufizoni autorizimin e fjalëkalimit në kohë dhe vendndodhje gjatë një ditë.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

22. Drejtorët e auditimit të brendshëm mund të përdorin një mjet të quajtur "analiza e rrezikut" në përgatitjen e orareve të punës. Cila nga të mëposhtmet NUK do të konsiderohej gjatë kryerjes së një analize të rrezikut?
- A. Aftësitë e disponueshme në stafin e auditimit.**
 - B. Rezultatet e auditimeve paraprake.
 - C. Ekspozimi financiar dhe humbja e mundshme.
 - D. Ndryshimet kryesore të operimit.
23. Në planifikimin e një sistemi të kontrolleve të brendshme operative, roli i auditorit të brendshëm është të:
- A. Hartoj kontrollet
 - B. Krijoj politikat për kontrollet
 - C. Krijoj procedurat për procesin e planifikimit
 - D. Vlerësoj efektivitetin e kontrolleve**
24. Çfarë veprimi duhet të ndërmarrë një auditor i brendshëm për të zbuluar që një fushë e auditimit ishte lënë jashtë programit të auditimit?
- A. Dokumentoni problemin në dokumentet e punës dhe mos ndërmerrni asnjë veprim tjetër derisa të udhëzoheni për ta bërë këtë.
 - B. Kryeni punën shtesë të nevojshme pa marrë parasysh kohën e shtuar për të përfunduar auditimin.
 - C. Vazhdoni auditimin siç është planifikuar dhe përfshini problemin e paparashikuar në një auditim pasues.
 - D. Vlerësoni nëse përfundimi i auditimit siç është planifikuar do të jetë adekuat.**
25. Në mënyrë që të përcaktohet shkalla e testeve të auditimit që do të kryhen gjatë punës në terren, përgatitja e programit të auditimit duhet të jetë hapi tjetër pas përfundimit të:
- A. Inspektimit paraprak.**
 - B. Inspektimit të politikave të ndërmarrjes.
 - C. Caktimit të personelit të auditimit.
 - D. Buxheteve kohore për detyra specifike të auditimit.
26. Gjatë një konference të daljes, një auditor dhe një i audituar nuk ranë dakord për një gjetje të auditimit të dokumentuar mirë. Cila nga opsionet e mëposhtme do të përshkruante një mënyrë të përshtatshme për të trajtuar situatën, duke supozuar që ajo nuk mund të zgjidhet para lëshimit të raportit të auditimit?
- A. Paraqitni gjetjen duke dhënë të gjitha faktet dhe konkluzionet që rezultojnë nga testimi.
 - B. Shtyni raportimin e gjetjes dhe planifikoni të kryeni punë më të hollësishme gjatë auditimit të ardhshëm.
 - C. Ndryshoni rezultatet për t'u pajtuar me pozicionin e të audituarit.
 - D. Paraqitni gjetjen e auditimit si dhe pozicionin e të audituarit për gjetjen.**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

27. Qëllimi i konferencës dalëse është që auditori i brendshëm të:

- A. Kërkoj veprime korrigjuese për mangësitë e gjetura.
- B. Rishikoj dhe verifikoj përshtatshmërinë e raportit të auditimit bazuar në kontributin e të audituarit.**
- C. Rishikoj performancën e personelit të auditimit të caktuar në angazhim.
- D. Paraqes menaxhmentit raportin përfundimtar të auditimit.

28. Një auditor i brendshëm është caktuar të kryejë një auditim të programit të sigurimit të kompanisë, duke përfshirë përshtatshmërinë e qasjes për të minimizuar rreziqet për kompaninë. Kompania vetë-siguron nga humbjet e mëdha të zakonshme dhe përfitimet shëndetësore të ofruara për të gjithë punonjësit e saj. Kompania është një firmë e madhe kombëtare me mbi 15,000 punonjës të vendosur në pjesë të ndryshme të vendit. Ai përdor një procedurë të jashtme të pretendimeve për të administruar programin e tij të kujdesit shëndetësor. Kostot mjekësore të kompanisë janë rritur afërsisht 8% në vit për pesë vitet e fundit, dhe menaxhmenti është i shqetësuar për kontrollimin e tyre.

Auditori duhet të përcaktojë qëllimin e auditimit të propozuar të mbulimit të sigurimeve nga kompania. Cila nga deklaratat e mëposhtme është (janë) të sakta në lidhje me fushën e mundshme të auditimit?

- I. Meqenëse është një auditim i brendshëm, departamenti i auditimit duhet të përqendrohet në përpunimin që ndodh brenda ndërmarrjes dhe jo në auditimin e korrektësisë së përpunimit të transaksionit nga përpunuesi i kujdesit shëndetësor.
- II. Auditori duhet të intervistojë menaxhmentin para fillimit të auditimit për të kuptuar (1) shqetësimet e tij dhe (2) supozimet themelore të bëra dhe arsyetimin e përdorur gjatë marrjes së vendimit të vetë-sigurimit.
- III. Auditori duhet të konsiderojë angazhimin e një konsulenti aktuarial për të kuptuar më mirë rreziqet e përfshira në mënyrë që të ndihmojë në përcaktimin e fushës së auditimit.

- A. Vetëm I
- B. Vetëm II
- C. I dhe II.
- D. II dhe III.**

29. Cila nga deklaratat e mëposhtme në lidhje me mbajtjen e letrave të punës së auditimit paraqet një politikë të papërshtatshme?

- A. Dokumentet e punës duhet të hudhen kur ato nuk kanë përdorim të mëtejshëm.
- B. Dokumentet e punës për auditimet e mashtremeve duhet të mbahen për një kohë të pacaktuar.**
- C. Këshilltari ligjor duhet të miratojë kohëzgjatjen e mbajtjes së letrës së punës.
- D. Kohëzgjatja e mbajtjes së dokumenteve të punës duhet të marr parasysh kërkesat ligjore dhe kontraktuale.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

30. Departamenti i auditimit të brendshëm të një kompanie ekziston që dhjetë vite. Departamenti ka krijuar një statut, i cili ende nuk është miratuar nga komiteti i auditimit. Sidoqoftë, komiteti i auditimit udhëheqet nga drejtori ekzekutiv (CEO) dhe përfshin kontrolluesin dhe një anëtar të jashtëm të bordit. Drejtori raporton drejtpërdrejt tek kontrolluesi i cili miraton planin e punës së auditimit të brendshëm. Kështu, departamenti i auditimit nuk e ka ndjerë kurrë nevojën për të kërkuar një aprovim zyrtar të statutit. Kompania tregtohet publikisht dhe ka nëntë divizione kryesore. Drejtori i mëparshëm i auditimit të brendshëm u shkarkua kohët e fundit pas një mosmarrëveshje midis drejtorit dhe një të audituari kryesor. CEO akuzoi drejtorin se nuk po vepronte "në interesin më të mirë të kompanisë". Sapo është punësuar një drejtor i ri me përvojë të konsiderueshme si në auditimin e jashtëm ashtu edhe në auditimin e brendshëm. Brenda muajit të parë, drejtori i ri hasi në rezistencë të konsiderueshme nga një i audituar në lidhje me natyrën e një auditimi dhe qasjen e departamentit të auditimit në regjistra.

Gjatë shqyrtimit të pavarësisë së departamentit të auditimit të brendshëm, cili nga faktet e mëposhtëm, në vetvete, mund të kontribuojë në mungesën e pavarësisë së auditimit të brendshëm?

- I. Drejtori i Përgjithshëm akuzoi drejtorin e mëparshëm se nuk vepronte "në interesin më të mirë të kompanisë".
- II. Shumica e anëtarëve të komitetit të auditimit vijnë nga brenda kompanisë.
- III. Statuti i auditimit të brendshëm nuk është aprovuar nga bordi ose komiteti i auditimit.

- A. Vetëm I
- B. Vetëm II
- C. I, II dhe III.
- D. II dhe III.**

31. Një dokument pune i auditimit është i plotë kur:

- A. Aktiviteti operacional që përshkruan bazën thelbësore të auditimit është përfshirë.
- B. Përmbledhja e kujdesshme e detajeve është e pranishme.
- C. Dokumentet e punës indeksohen siç duhet dhe ndër indeksohen.
- D. Objektivi i auditimit është përmbushur.**

32. Cila nga aplikacionet e mëposhtëm mikrokompjuterike do të ishte shumë pak i dobishëm në përgatitjen e letrave të punës së auditimit?

- A. Softueri i fletëllogaritjes.
- B. Softuer për përpunimin e fjalëve.
- C. Softueri i shërbimeve.**
- D. Softueri i bazës së të dhënave.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

33. Një auditor i brendshëm në një kompani të shitjeve me pakicë raporton tek drejtori i auditimit të brendshëm të korporatës. Auditori është caktuar të auditojë një divizion rajonal. Raportet e auditimit duhet të dërgohen në zyrën e korporatës si dhe tek kontrollori i divizionit rajonal. Auditori ka qenë në vendndodhje për gjashtë muaj dhe ka dorëzuar raporte mujore, çdo muaj duke kontrolluar një pjesë të operacionit siç është caktuar nga auditimi i brendshëm i korporatës. Këtë muaj, për herë të parë, auditori ka audituar kontrollat e inventarit, duke ndjekur procedurat e vendosura nga stafi i auditimit të brendshëm të korporatës.

Pasi pa raportin e auditimit mbi kontrollin e inventarit, kontrollori i divizionit thirri dhe kërkoi një takim me auditorin. Në takim, kontrollori i divizionit kritikoi me zë të lartë dhe në mënyrë abuzive saktësinë e punës së auditorit, qëndrueshmërinë e metodave të auditorit dhe rezultatet e paraqitura në raporte. Në të kaluarën, megjithëse nuk ishte gjithmonë dakord me konkluzionet e auditorit, kontrollori i divizionit gjithmonë kishte diskutime racionale dhe zhvilloi hapat e duhur vijues për të korrigjuar problemet që auditori gjente.

Pavarësisht se kurrë nuk e kishte thënë kështu, kontrollori i divizionit gjithmonë kishte menduar që puna e auditorit ishte nën standard. Kontrolluesi i divizionit mund ta ketë trajtuar më mirë situatën duke:

- A. Siguruar trajnim për auditimin e kontrolleve të inventarit në mënyrë që auditori të bëjë një punë më të mirë herën tjetër.
- B. Dokumentuar mangësitë rregullisht dhe duke raportuar tek drejtori i auditimit të brendshëm.**
- C. Diskutuar punën e auditorit me auditorë të tjerë të brendshëm për të krahasuar metodat e auditorit me të tjerët të përdorur në kompani.
- D. Thirrur e drejtorin e auditimit të brendshëm të korporatës dhe insistimi që auditori të zëvendësohet.

34. Gjatë një auditimi të blerjeve, auditorët e brendshëm gjetën disa shkelje të politikës së kompanisë në lidhje me ofertat konkurruese. E njëjta gjendje ishte raportuar në një raport të auditimit vitin e kaluar dhe veprimet korrigjuese nuk ishin ndërmarrë. Cila nga opsionet e mëposhtme përshkruan më mirë veprimin e duhur në lidhje me këtë gjetje të përsëritur?

- A. Raporti i auditimit duhet të theksojë se e njëjta gjendje ishte raportuar në auditimin paraprak.
- B. Drejtori i auditimit të brendshëm duhet të përcaktojë nëse menaxhmenti ose bordi ka marrë përsipër rrezikun e mos ndërmarrjes së veprimeve korrigjuese.**
- C. Drejtori i auditimit të brendshëm duhet të përcaktojë nëse kjo gjendje duhet raportuar tek auditori i pavarur dhe ndonjë agjenci rregullatore.
- D. Gjatë konferencës dalëse, menaxhmenti duhet të ndërgjegjësohet se gjetja nga raporti paraprak nuk ishte korrigjuar.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

35. Pas rishikimit të rezultateve të raportit të auditimit me komitetin e auditimit, menaxhmenti ekzekutiv ra dakord të pranojë rrezikun e mos zbatimit të veprimeve korigjuese për gjetjet e caktuara të auditimit. Vlerësoni opsionet e mëposhtme dhe zgjidhni alternativën më të mirë për drejtorin e auditimit të brendshëm.
- A. Njoftoni autoritetet rregullatore për vendimin e menaxhmentit.
 - B. Kryeni hapa shtesë të auditimit për të identifikuar më tej shkeljet e politikave.
 - C. Kryeni një auditim vijues për të përcaktuar nëse janë ndërmarrë veprime korigjuese.
 - D. Përgjegjësia e auditimit të brendshëm është përmbushur dhe nuk kërkohet asnjë veprim i mëtejshëm i auditimit.**
36. Të dhënat e mëposhtme u mbledhën gjatë një hetimi të auditimit të brendshëm për shkak të një rritje materiale në shpenzimet e borxheve të këqija. Gjatë përgatitjes së një raporti të gjetjeve, secili prej artikujve mund të klasifikohet si kritere, shkak, gjendje, pasojë ose informacion historik.
- I. Porositë shumë të mëdha kërkojnë miratimin e kredisë nga menaxhmenti.
 - II. Testet e auditimit treguan se personeli i shitjeve rregullisht shpërfill udhëzimet e kredisë kur merren me klientë të vendosur.
 - III. Një raport mujor i fshirjeve përgatitet por i shpërndahet vetëm departamentit të kontabilitetit.
 - IV. Raportet e kredisë përdoren vetëm në llogaritë e reja.
 - V. Të dhënat e departamentit të kontabilitetit sugjerojnë që llogaritë e pa arkëtueshme mund të rriten me 5% për vitin aktual.
 - VI. Humbja e borxheve të këqija u rrit me 100,000 Euro gjatë vitit të fundit fiskal.
 - VII. Edhe pse procedurat dhe kriteret u ndryshuan për të zvogëluar sasinë e fshirjeve të borxheve të këqija, humbja e komisioneve për shkak të llogarive të fshira është rritur për disa personel të shitjeve.
 - VIII. Politika e departamentit të kredisë kërkon rishikimin e referencave të kredisë për të gjitha llogaritë e reja.
 - IX. Regjistrimet e tanishme të pagesave duhet të rishikohen përpara se të zgjasin kredi shtesë për të hapur llogari.
 - X. Për të ulur kostot, përdorimi i raporteve të kreditit të jashtëm u pezullua në disa raste.
 - XI. Meqenëse disa pozicione të stafit në departamentin e kredisë u eliminuan për të ulur kostot, disa llogari të reja kanë marrë vetëm rishikim të përkohshëm.
 - XII. Sipas menaxherit të ri të kredisë, respektimi i rreptë i politikës së vendosur të kredisë nuk është i nevojshëm.

Artikujt të cilët mund të klasifikohet si kritere ilustrohen më së miri tek gjetjet:

- A. I, VIII dhe IX**
- B. II, X, XI
- C. III, IV dhe XII
- D. V, VI dhe VII

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Mrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

37. Një raport i auditimit operativ që merret me funksionin e hedhjes së mbeturinave në një kompani prodhuese duhet të adresojë:
- A. Efikasitetin dhe efektivitetin e funksionit të hedhjes së mbetjeve dhe të përfshijë çdo gjetje që kërkon veprim korigjues.**
 - B. Nëse inventari i materialit për hedhje raportohet si një pasuri qarkulluese.
 - C. Nëse llogaritja e inventarit fizik të materialit për hedhje është në përputhje me shumën e regjistruar.
 - D. Nëse inventari i materialit për hedhje vlerësohet në koston më të ulët ose në vlerën e tregut.
38. Cili nga individët e mëposhtëm normalisht NUK do të merrte një raport të auditimit të brendshëm në lidhje me një rishikim të ciklit të blerjes?
- A. Drejtori i blerjes.
 - B. Kryetari i bordit të drejtorëve.**
 - C. Auditori i jashtëm i pavarur.
 - D. Auditori i përgjithshëm.
39. Po lëshohet një raport i auditimit me gjetjet e zakonshme për departamentin e llogarive të pagueshme. Shpërndarja e raportit duhet të përfshijë mbikëqyrësin e llogarive të pagueshme, menaxherin dhe menaxherin e përgjithshëm të njësisë. Raporti mund të dërgohet gjithashtu tek:
- A. Menaxheri i blerjeve dhe drejtori i operacioneve.
 - B. Menaxheri i marrjes së porosive, menaxheri i blerjes dhe drejtori i operacioneve.
 - C. Auditorët e jashtëm dhe kontrolluesi i korporatës.**
 - D. Auditorët e jashtëm, kontrolluesi i korporatës dhe kryetari i bordit të drejtorëve.
40. Drejtori i auditimit të brendshëm të një kompanie shumëkombëshe duhet të formojë një ekip auditimi për të ekzaminuar një filial të sapo blerë në një vend tjetër. Cilët nga faktorët e mëposhtëm duhet pasur parasysh?
- I. Zakonet lokale.
 - II. Aftësitë gjuhësore të auditorit.
 - III. Përvoja e auditorit.
 - IV. Kursi monetar i këmbimit.
- A. I dhe III
 - B. I dhe II
 - C. II, III dhe IV
 - D. I, II dhe III**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Grumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

41. Nëse stafi i auditimit të brendshëm nuk ka aftësi për të kryer një detyrë të veçantë, mund të angazhohet një specialist nga:
- I. Firma e auditimit të jashtëm të organizatës.
 - II. Një firmë e jashtme këshilluese.
 - III. Departamenti që aktualisht po auditohet.
 - IV. Një koleg apo universitet.
- A. I dhe II
 - B. II dhe IV
 - C. I, II dhe III
 - D. I, II dhe IV**
42. Cila nga opsionet e më poshtë do të ishte burimi më i mirë i informacionit për një drejtor të auditimit të brendshëm për planifikimin e kërkesave të personelit?
- A. Rishikimi i të dhënave të arsimimit dhe trajnimit të stafit të auditimit.
 - B. Rishikoni madhësinë e stafit të auditimit dhe përbërjen e kompanive të përmasave të ngjashme në të njëjtën industri.
 - C. Diskutimet e nevojave të auditimit me menaxhmentin ekzekutiv dhe komitetin e auditimit.**
 - D. Intervistat me stafin ekzistues të auditimit.
43. Procesi i rishikimit të punës së kolegëve mund të kryhet nga brenda ose jashtë. Një tipar dallues i rishikimit të jashtëm është qëllimi i tij të:
- A. Identifikoj detyrat që mund të kryhen më mirë.
 - B. Siguroj një vlerësim të pavarur.**
 - C. Përcaktoj nëse aktivitetet e auditimit përmbushin standardet profesionale.
 - D. Përcaktoj rekomandimet për përmirësim.
44. Mjeti më i mirë për departamentin e auditimit të brendshëm për të përcaktuar nëse qëllimi i tij për të zbatuar një auditim më gjithëpërfshirës të aktiviteteve funksionale është përmbushur është përmes:
- A. Grumbullimit të gjetjeve të auditimit sipas zonës së auditueshme.
 - B. Krahasimit të planit të auditimit me aktivitetin aktual të auditimit.**
 - C. Sondazhet e kënaqësisë së menaxhmentit me funksionin e auditimit të brendshëm.
 - D. Zbatimi i një programi të sigurimit të cilësisë.
45. Bërja e sigurt se të gjithë punonjësit kanë të njëjtin vizion si edhe kompania është shembull i kontrolleve:
- A. Parandaluese**
 - B. Zbuluese
 - C. Rimëkëmbjes
 - D. Parandaluese dhe Zbuluese

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

46. Në rastet kur dyshohet që në regjistrat kontabël janë bërë nën-vlerësime të vlerave monetare një auditor zakonisht duhet të filloj auditimi nga:
- A. Dokumentet burimore dhe të ecni përpara për të arritur tek pasqyrat financiare**
 - B. Pasqyrat financiare dhe të ecni prapsht për të arritur tek dokumentet burimore
 - C. Analizimi i të dhënave të viteve të kaluara
 - D. Analizimin e numrit dhe natyrës së transaksioneve të veçanta që janë trajtuar.
47. Një memorandum i intervistës me një dëshmitar duhet të përmbajë cilat nga këto elemente:
- A. Natyra e intervistës, Data e kryerjes së intervistës, Identiteti i intervistuesit
 - B. Natyra e pyetjeve të bëra, Data e kryerjes së intervistës, Metoda e kryerjes së intervistës
 - C. Natyra e pyetjeve të bëra, Natyra e intervistës, Data e kryerjes së intervistës, Metoda e kryerjes së intervistës, Identiteti i intervistuesit**
 - D. Natyra e intervistës, Data e kryerjes së intervistës, Metoda e kryerjes së intervistës.
48. Analiza e prirjeve si një lloj i procedurave analitike shqyrton cilën nga opsionet e më poshtme:
- A. Tendencat (trendët) e tepricave të llogarive si një bazë për të përcaktuar nëse ka apo jo mundësi që të dhënat e periudhës aktuale të përmbajnë anomali**
 - B. Procedurat që përfshijnë analizën e njëkohshme të dy ose më shumë llogarive të pasqyrave financiare.
 - C. Lidhjen e supozuar të konsistencës midis llogarive
 - D. Marrëdhëniet e rëndësishme dhe konsistente midis të dhënave financiare dhe atyre operacionale.
49. Analizimi i pasqyrave financiare, Përfitimi i mostrave statistikore, Teknikat e paraqitjes grafike të rrjedhjes së punës paraqesin shembuj të:
- A. Procedurave analitike**
 - B. Procedurave thelbësore
 - C. Teknikave të modelimit
 - D. Analizës së prirjeve
50. Cilat janë karakteristikat e një raporti të mirë hartuar mbi mashtrimet:
- A. Saktësia, Qartësia, Paanësia.
 - B. Qartësia, Paanësia, në kohë.
 - C. Saktësia, Qartësia, Paanësia, Domethënia, në kohë.**
 - D. Saktësia, Qartësia, Paanësia, në kohë.